



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.976/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Milena Djerić e Rafet Haxhaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses – propozuesës së masës së sigurimit F.M nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson e autorizuar e saj av.Z.B nga Ferizaj, kundër të paditurit – kundërshtarit së sigurimit I.H nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij Sh.J nga Ferizaj, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të kontributit në bashkësi martesore, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.988/2021, të datës 27.10.2021, me të cilin është refuzuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 01.03.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses F. M nga Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.988/2021, i datës 27.10.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me pikën I të aktvendimit të ankimuar C.nr.988/21, të datës 27.10.2021, e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit të propozuesës F.M nga Ferizaj, me të cilin ka kërkuar që t'i caktohet masa e sigurimit ndaj kundërpropozuesit të sigurimit I.H nga Ferizaj, t'i ndalohej që t'i shes dhe të mos kontraktojë, të mos ngarkoj ngastrat hipotekare për paluajtshmëritë - njësitë kadastrale P-72217092-01061-4, P-71409059-00579-0, P-71409059-00581-1, P-71409059-00590-1, P-71409059-00590-2, P-71409059-00590-3, P-71409059-00590-4, P-71409059-0591-0, të gjitha këto deri në plotfuqishmërinë e kësaj çështje kontestimore, apo deri në ndonjë vendim tjetër të kësaj gjykate dhe të detyrohet Zyra Kadastrale në Komunën e Ferizajt dhe Noterët e Regjionit të Ferizajt që këtë masë ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, paditësja – propozuesja e masës së sigurimit ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, me

propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj dhe propozimin e propozuesës ta miratoj, ose që aktvendimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallë së parë në rigjykim.

Paditësi - kundërpropozuesi ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses, me propozim sikurse në të njëjtën.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontesti more (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditëses – propozuesës së sigurimit, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja – propozuesja e masës së sigurimit me datën 21.07.2021, pranë gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurit, për vërtetimin e pronës sipas bazës së kontributit të bashkëshortes, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, më arsye sikurse në padi.

Me aktvendimin e ankimuar C.nr.988/21, të datës 27.10.2021, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së propozuar, me arsyetimin se pala paditëse – propozuesja e masës së sigurimit, më padi ka kërkuar vendosjen për masën e sigurisë për rrezikshmërinë e shitblerjes se pronës ndaj të paditurit - kundërshtarit të masës, në ndërkohë që pasi janë administruar provat e propozuara është provuar se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, në këtë fazë të procedurës, është i pa bazuar pasi që pala paditëse nuk ka ofruar asnjë provë materiale që e bëjnë të besueshme të drejtën subjektive të saj, në kuptim të nenit 297.1 pika b) të LPK, e po ashtu gjykatës nuk i janë ofruar as prova materiale të mjaftueshme që të vërtetonin kushtin tjetër të paraparë me nenin 297.2 të LPK, për ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar pala paditëse do të mund të pësoj dëm të riparueshëm. Tutje gjykata në fjalë ka konstatuar se në as një mënyrë, në asnjë formë këtu i padituri – kundërshtari i masës, nuk mund të ndikoj që pala kundërshtare, në rastin konkret pala propozuese, të pëson dëm të riparueshëm ku pastaj kjo do të mund të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesës të sigurimit, andaj përfundimisht gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se caktimi i masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës është i pabazuar, pasi që propozuesja nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së saj subjektive ndaj të cilës është propozuar masa e sigurisë. Me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 387.1 lidhur me nenin 142.5 të LPK.

Gjykata e Apelit e Kosovës, e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet tjera ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallë së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë të parashtruar nga propozuesi.

Sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipërtheksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret nuk kanë qenë të plotësuara kushtet për caktimin e masës së sigurimit për shkak se propozuesja nuk e ka bërë të besueshme të drejtën e saj subjektive dhe rrjedhimisht nuk është provuar se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohej apo do të vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës së saj si pasojë e refuzimit të kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme se në këtë rast, në rrethanat aktuale, nuk mund të ofrohet mbrojtje gjyqësore për sigurimin e kërkesëpadisë së paditëses, siç ka propozuar kjo e fundit. Mbi bazën e tërë të lartcekurave Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar propozimin e propozuesit, për caktimin e masës së propozuar të sigurisë sikurse në aktvendimin e ankimuar.

Meqenëse në rastin në fjalë objekti i lëndës ka të bëjë me sigurimin e kërkesëpadisë së paditëses, gjykata nuk e sheh të arsyeshme që të lëshohet në elaborimin e mëtutjeshëm për meritat e rastit, për të cilin aspekt gjykata e shkallës së parë do të vendos në ndërkohë.

Përndryshe pavarësisht të lartcekurave, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rast të ndonjë ndryshimi qenësor të rrethanave të rastit, të cilat rrethana do të mund të ndikonin në realizimin e të drejtave subjektive civile të propozueses së masës së sigurimit, kjo e fundit dhe jo vetëm, mund ta shfrytëzoj të drejtën e saj që sërish të kërkoj nga gjykata caktimin e masave siguroese, për sigurimin e kërkesëpadisë së tij. Po ashtu, Gjykata e Apelit thekson së vendimi lidhur me masën e sigurisë nuk përfaqëson çështje të gjykuar, e as nuk e prejudikon vendosjen e çështjes në lidhje me meritat e tij. Por, në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë për shkak se gjykata e shkallës së parë përfundimin e saj e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë por ka gjetur se të njëjtat në rrethanat aktuale të rastit janë të pathemelta dhe se nuk kanë pasur ndikim që gjykata të merre një vendim ndryshe.

Nga të cekurat si më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.976/2022, me datën 01.03.2022

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj